




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

DPK

Nr. Prot. 03-03/2494/18
Data 22-08-2018

Nr. I treg. 03
Broj stranica
Nr. pages

DATË/A:	17.08.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-2413/18
PËR/ZA/TO:	z. Muhamet LAMA, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit " Gjakova " sh.a.
CC:	z. Ismet AHMETI, Drejtor Menaxhues në Kompaninë Rajonale të Ujësjetllësit " Gjakova " sh.a.
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Përfundimi i punimeve të ujësjetllësit për 28 fshatra - Gjakovë "



I nderuari z. LAMA,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull " **Përfundimi i punimeve të ujësjetllësit për 28 fshatra - Gjakovë** ", me numër të prokurimit: KRUGJA-18-5532-511, dhe me nr. të brendshëm: KRURGJA-18-017-511, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " **Përfundimi i punimeve të ujësjetllësit për 28 fshatra - Gjakovë** ", me numër të prokurimit: **KRUGJA-18-5532-511**, dhe me nr. të brendshëm: **KRURGJA-18-017-511**, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit

për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 17.08.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *AKK-03-03-2413/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Përfundimi i punimeve të ujësjellësit për 28 fshatra - Gjakovë*", me numër të prokurimit: *KRUGJA-18-5532-511*, dhe me nr. të brendshëm: *KRURGJA-18-017-511*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Kompania Rajonale e Ujësjellësit Rajonal "Gjakova" sh.a.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se Autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike të llojit punë, me vlerë të madhe në shumë prej 2.500.540,00 €.

Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit ka konstatuar se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional tek pika 1a*, është kërkuar si në vijim: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses në lëmin e ndërtimit të ujësjellësve në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku një punë – kontratë në vlerë prej 5.000.000,00 €. Ndërsa tek pika 1b, është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses në lëminë e ndërtimit të gyp sjellësit (gyp çeliku më e madhe se DN400) në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, së paku 1 punë – kontratë në vlerë prej 1.000.000,00 €. ***Kërkesa këto për të cilat AKK konsideron se nuk janë në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.***

Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2. parashihet se Autoriteti kontraktues mund të kërkoj " Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, Autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me Autoritetin Publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse të i'a paraqes drejtpërdrejtë Autoritetit kontraktues ".

Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të referencave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për Autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktues

pavarësisht numrit të referencave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i projekteve në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të kryejnë punë të ngjashme, andaj, Autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj vlera minimale në lidhje me punët në tri vitet e fundit.

Veprimet e Autoritetit kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !